

GEMEINSAM FÜR EIN
GUTES LEBEN



Si anëtarë e keni më të lehtë.

egzistojnë shumë arsye për anëtarësim në
IG Metall.

IG Metall: Së bashku për një jetë më të mirë.

A dëshironi të kontriboni për paga korrekte, kushte të mira të punës dhe më shumë drejtësi? Ne, poashtu.

Jeta e mirë është **punë e mirë.**

Ne- IG Metall: Me më shumë se 2,2 milion anëtarë kontribojmë në vazhdimësi për punë të mirë. Sepse puna paraqet një element të caktuar të jetës tonë. Për të mundësuar një jetë më të mirë, është e nevojshme fuqia krijuese e një shoqërie të fortë.

Kontratave Kolektive i përcaktojnë standardet

A dëshironi **kushte të rregulluara** dhe ofrimin **e tyre?**

Shërbimi jonë më i fortë është ofrimi i kontratave tona kolektive. Përmes tyre bëhet rregullimi i kushteve të punës si lartësia e pagës, orët javore të punës, të drejtës së pushimit dhe shtesat, të drejtës për marrje në punë pas kryerjes së edukimit, të drejtës së shkollimit të mëtejshëm si dhe mundësinë për dalje në pension gradualisht. Këto kontrata vlejnë për industrinë e metalit dhe atë elektrike, për industrinë e hekurit dhe çelikut, për sektorët e tekstilit dhe veshjeve, të drurit dhe plastikës, për sektorin e teknologjisë së informimit dhe komunikimit

mit si dhe për profesionet automobilistike dhe elektrike. Dhe ato nuk ndikojnë vetëm në kompanitë e lidhura përmes marrëveshjes kolektive, por përcaktojnë rregulla për tërë industrinë.

➔ www.igmetall.de/tarife

Mbrojtja juridike § 27 i Statutit të IG Metall

A dëshironi **këshilla të mira dhe përfaqësim të mirë?**

Ne ju japim përgjigje në të gjitha pyetjet tuaja rreth botës së punës. Nëse bëhet fjalë për klasifikim, verifikim të kontratave apo diplomave, vendimeve për ndërprerje të punës apo vendime për pensione ne jemi me ju me këshilla dhe vepra. Në rast të kontesteve eventuale ju si anëtarë mund të shërbeheni me këshillat tona juridike. Ne ju përfaqësojmë në procedura jashtëgjyqësore, por natyrisht edhe në gjykatë nëse paraqitet nevoja. Ne ju përfaqësojmë në të gjitha rastet e Ligjit të punës dhe Ligjit social – pra edhe në agjensionin e punës, sigurimin shëndetësor, sigurimin pensional apo me shoqatat profesionale.

➔ www.igmetall.de/rechtsschutz

Përkrahja §§ 23 dhe 24 i statutit të IG Metall

A dëshironi të jepni **kontributin tuaj edhe në bashkëpunim me të tjerët?**

Ne ju përkrahim ju dhe kolegët tuaj në kontestet me kompanitë: Këshilltarët sindikal IG Metall janë të trajnuar mirë, zyrja IG Metall në vend e njeh mirë gjendjen

e kompanive dhe angazhimi juaj atje është shumë i nevojshëm. IG Metall është i domosdoshëm në themelimin e këshillave të sindikates edhe në rast të kontesteve lidhur me marrëveshjen kolektive. Në rast se gjatë konflikteve lidhur me marrëveshjen kolektive vjen deri te greva, IG Metall u ofron anëtarëve të saj natyrisht edhe përkrahje financiare sipas Statutit.

➔ www.igmetall.de/leistungen

Shërbime të tjera §§ 26, 28, 30 i Statutit të IG Metall

A vazhdon **solidariteti** për ju edhe jashtë derës së fabrikës?

Ne ju përkrahim edhe në rast të aksidenteve që ndodhin jashtë vendit të punës. Sigurimi jonë për aksidentet që ndodhin gjatë kohës së lirë vlen në tërë botën, pavarësisht nëse keni pësuar fatkeqësi në shtëpi, në kopësht, apo gjatë udhëtimit: qofshin ato me vetura, motoçikleta apo biçikleta malore-nëse keni qëndruar më shumë se 48 orë në spital, do të kemi ndërhyrjen e sigurimit.

Gjendjet e jashtëzakonshme emergjente dhe katastrofat që e rrezikojnë jetën kërkojnë përkrahje të shpejtë dhe pa komplikime- IG Metall u ofron këtë ndihmë si p.sh. me rastin e katastrofave të vërshimeve në vitet 2013 dhe 2016.

Dhe nëse vjen deri te më e keqja, ne ofrojmë përkrahje edhe në raste të vdekjes për Anëtarët tanë, përkatësisht trashëgimtarët e tyre, sipas Statutit.

➔ www.igmetall.de/leistungsrechner

Informohuni**A dëshironi të jeni të informuar dhe të njoftuar?**

Ne ju informojmë në mënyrë gjithpërfshirëse rreth çështjeve të rëndësishme sindikale dhe shoqërore nëpërmjet fletushkave, doracakëve dhe në faqen specifike për informim në internet. Në kuadër të seminareve tona ne ofrojmë kualifikimin e mëtejshëm për pyetjet e politikës dhe të drejtave sindikale. Për shkëmbime të njohurive praktike me njëri-tjetrin ne kemi forume rrjete të tilla, si për shembull për femra, studentë apo persona me shkollim të lartë.

Revista jonë për Anëtarë **metallzeitung** ju ofron çdo muaj informata të reja nga shtypi, raporte, reportazhe dhe gjërave që duhen ditur nga bota e punës.

Të gjitha ofertat ofrohen pa pagesë për anëtarët tanë.

»Përfaqësimi i përshtatshëm dhe i fuqishëm i punëtorit të degës së metalurgjisë në fushën sociale varet nga anëtarësimi ne IG Metall.«

Sipas aktgjykimit të Gjykatës federale të shpallur më 10.12.1984, II ZR 91/84

A keni pyetje të tjera ?

Në rast se keni pyetje rreth anëtarësimit në IG Metall apo rreth çështjeve të tjera lidhur me punë të sigurtë dhe të mirë, jemi në dispozicionin tuaj.

✉ **mitglieder@igmetall.de**

☎ **069 66 93-2221**



Wir. Die IG Metall.

Prezantimi i shoqatës sindikale.

Revista jonë »Wir. Die IG Metall« paraqet në mënyrë të qartë qëndrimin tonë, ofertat tona dhe sqaron kuptimin dhe rëndësinë e shoqatave sindikale. Këtë revistë mund ta gjeni në çdo pako informative dhe porosia pa pagesë mund të bëhet online përmes faqes së internetit

➔ **www.igmetall.de/duauch**

Portalin »Über-Uns-Portal« mund ta gjeni në faqen e internetit

➔ **wir.die-igmetall.de**

Lidhuni në rrjet dhe informohuni. Porosia për gazetën tonë mund të bëhet në faqen e internetit

➔ **www.igmetall.de/infoservice**

Të fortë në vend.

Nga Flensburg deri në Lörrach, nga Aachen deri në Bautzen.



Ne jemi aty – në të gjithë Gjermaninë.

➔ www.igmetall.de/vor-ort

Më shumë se **150**

zyra në 7 rrethe

Më shumë se **135.000**

zyrtarë aktiv

Më shumë se **2,2**

milion anëtarë

Më shumë se **53.000**

IG Metall-Këshilltarë të sindikatës në

më shumë se **18.000**

kompani në 30 dega të ekonomisë

IG Metall na bashkon.

Ne jemi shumë.

Ejani edhe ju me ne.



facebook.com/igmetall

flickr.com/igmetall

twitter.com/igmetall

youtube.com/igmetall



Po, edhe unë jam me ju.

Ju lutem, dorëzimi të bëhet në këshilla të sindikatës së IG Metall, anëtarëve të besueshëm, apo tek IG Metall në vend. Apo thjeshtë të futet në zarf dhe të dërgohet.

IG Metall-Vorstand

FB Mitglieder und Erschließung

60519 Frankfurt am Main

A është më mirë të anëtarësohem drejtpërdrejt online?

➔ www.igmetall.de/beitreten

